A.K.P.A.
Nr 2769 Prot.
Datë,më 15.10.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE " NAZMI RUSHITI"DIBËR

Nr. 558 prot.

Peshkopi, më 16.10.2026

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
TIRANË

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit:të ligjit nr.15/2017,datë 16.02.2017 " Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",të vendim të Këshillit të Ministrave nr. 554,datë 31.07.2019, "Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe fuksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive datë si dhe Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024 " Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë,menaxhimin e burimeve njerëzore,përberjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"i ndryshuar.

Ofruesi publik i AFP - së - shkolla e mesme profesionale " Nazmi Rushiti " Dibër, ju njofton krijimin e vendit të lire : për pozicionin :

-Mësues i teorisë dhe praktikës profesionale me kohë të plotë ,Drejtimi Hoteleri-Turizëm,1(një mësimdhënës).

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

A – Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon ;

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon ;

a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së,për të cilin po aplikon
b) Të ketë të paktën 1(një) vit përvojë pune në fushën,në të cilën ka kryer studimet
c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2.Dokumentet e aplikimit

Dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
a) letërmotivimin për pozicionin;
b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi
c) kartën e identitetit;
d) diplomën
e) librezën e punës;
f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) çertifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit
h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit,që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
i) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm

- ✓ *Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.*
- ✓ *Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të noterizuara*

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda datës 26.10.2026

3.Vlerësimi i kandidatëve do të behet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759,datë 30.09.2024 " Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë,menaxhimin e burimeve njerëzore,përberjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"i ndryshuar.

DREJTORI

Majlinda POÇI

Adresa :Rruga "Kongresi i Dibrës"Peshkopi, E-mail:nazmirushiti21@gmail.com